



## **Përmbajtja**

|                                                       |   |
|-------------------------------------------------------|---|
| 1. Hyrje .....                                        | 3 |
| 2. Përkrahja financiare e ofruar nga MINT/ KIESA..... | 3 |
| 4. Subjektet afariste që nuk kualifikohen .....       | 5 |
| 5. Kohëzgjatja .....                                  | 5 |
| 7. Si te aplikohet? .....                             | 6 |
| 8. Kriteret e vlerësimit.....                         | 7 |
| 9. Ankesat .....                                      | 7 |

## 1. Hyrje

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), lanson skemën e granteve për blerje të makinerive prodhuese dhe përpunuese për sektorin privat, në veçanti për sektorët sipas analizës së politikës industriale e cila ka për qëllim transformimin strukturor në një industri më të integruar globalisht që është në gjendje të prodhojë produkte me vlerë të lartë të shtuar.

Për të arritur këtë synim, sipas analizës së performancës industriale dhe studimeve të zingjirëve të vlerës për zhvillim industrial dhe mbështetje të bizneseve, janë identifikuar nën sektorët me potencial më të lartë për të arritur plotësimin e objektivave të politikës industriale. Prandaj, grant skema ka për qëllim të kontribuojë në rritjen e prodhimit dhe përpunimit, përmirësimin e bilancit tregtar përmes rritjes së eksportit apo rritjes së pjesëmarrjes së produkteve vendore në tregun vendor, rritjes së investimeve dhe punësimit, duke përfshirë edhe nxitjen e bizneseve që të kontribuojnë dhe përfitojnë përmes ekonomisë qarkore.

MINT, respektivisht KIESA fton Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) që të aplikojnë për përkrahje financiare përmes kësaj skeme sipas klasifikimit të NACE Rev2 ku fushë veprimtaria primare ose sekondare duhet të jetë në njërin nga kodet si në vijim:

- |                  |                                                                            |
|------------------|----------------------------------------------------------------------------|
| • Kodi 10        | Përpunimi i produkteve ushqimore                                           |
| • Kodi 11        | Prodhim/përpunim i pijeve                                                  |
| • Kodi 16 dhe 31 | Prodhim/përpunim i drurit dhe mobileve                                     |
| • Kodi 20        | Prodhim/përpunim i produkteve kimike                                       |
| • Kodi 22        | Prodhim/përpunim i produkteve të gomës dhe plastikes                       |
| • Kodi 23        | Prodhim/përpunim i produkteve minerale jo metalike                         |
| • Kodi 24 dhe 25 | Prodhim/përpunim i metaleve dhe prodhimi i produkteve të fabrikua metalike |
| • Kodi 27        | Prodhim/përpunim i pajisjeve elektrike                                     |
| • Kodi 28        | Prodhim/përpunim i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.                         |

## 2. Përkrahja financiare e ofruar nga MINT/KIESA

Shuma totale e kësaj thirrje është 500,000.00 euro. Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion. Përkrahja financiare për ndërmarrjet do të ndahet përmes tre kategorive si në vijim:

- Lot 1 – Ndërmarrjet mikro, të punësuar deri në 9 punëtorë mund të përfitojë në vlerë maksimale deri në 20,000 euro, ndërsa ndërmarrja obligohet të bashkë financoj jo më pak se 30% për kompletim të projektit. Buxheti total për këtë kategori është 100,000.00 euro.
- Lot 2 – Ndërmarrjet e vogla të punësuar 10 deri në 49 punëtorë mund të përfitojë në vlerë maksimale deri në 20,000 euro, ndërsa ndërmarrja obligohet

të bashkë financoj jo më pak se 40% për kompletim të projektit. Buxheti total për këtë kategori është 200,000.00 euro.

- Lot 3 – Ndërmarrjet e mesme të punësuar 50 deri në 249 punëtorë mund të përfitojë në vlerë maksimale deri në 20,000 euro, ndërsa ndërmarrja obligohet të bashkë financoj jo më pak se 50% për kompletim të projektit. Buxheti total për këtë kategori është 200,000.00 euro.

#### **Shënim:**

- Vlerësimi i aplikuesve bëhet ndërmjet kategorive sipas madhësisë së ndërmarrjes: mikro me mikro, të vogla me të vogla dhe të mesme me të mesme.
- Teprica e buxhetit në ndonjërin nga Lot-et, mund të bartet në Lot-et tjera.

### **3. Dokumentet e kërkuara sipas Udhëzimit Administrativ 01/2018**

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Certifikatën e numrit fiskal (nuk aplikohet për bizneset të cilat numrin e regjistrimit të biznesit dhe numrin fiskal e kanë në një certifikatë).
- Vërtetim tatimor me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK.
- Listën e punëtorëve për vitin 2023 të lëshuar nga ATK (mund të nxjerrët online nga ueb faqja e ATK-së). Në bazë të listës do të kategorizohen dhe vlerësohen ndërmarrjet si: mikro, të vogël apo e mesme dhe gjinia femërore.<sup>1</sup>
- Kopjen e letërnjoftimit të personit/ve në emër të cilit/ve është i regjistruar aplikuesi.
- Dëshmi nga aplikuesi së nuk është nën falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Themelore. Kërkohet origjinali jo më i vjetër se 30 ditë.
- Dëshminë e xhirollogarisë aktive të aplikuesit në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.
- Gjendjen e xhirollogarisë bankare të aplikuesit për vitin e fundit (2023). Për aplikuesin e sapo themeluar kjo nuk është e aplikueshme.
- Projekt-propozimin që përfshin: qëllimin, aktivitetet e projektit, koston financiare, planin kohor të realizimit të projektit dhe strukturën organizative të aplikuesit.<sup>2</sup>
- Të mos ketë pranuar mjete nga burimet tjera të financimit për të njëjtat aktivitete (e dëshmuar me deklaratë nën betim).

---

<sup>1</sup> Lista e punëtorëve për vitin 2023 e lëshuar nga ATK me emrin e subjektit aplikues në harmoni me NUI.

<sup>2</sup> Forma që duhet të plotësohet mund të shkarkohet nga portali e-Kosova

- Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit nga MINT për dy vitet fundi (e dëshmuar me deklaratë nën betim).
- Ndërmarrja duhet të dorëzojë pro faturën ose para kontratën ku do ta certifikoj produktin dhe të dëshmojë se trupi certifikues është i akredituar nga një trup akreditues i njohur ndërkombëtarisht.

Në harmoni me kriteret e lartpërmendura, pako e aplikuesit duhet të përmbajë:

Shtojca A Aplikacioni  
Shtojca B Buxheti  
Shtojca C Projekt propozimi

### **Shënim:**

Në mungesë të cilitdo dokument të kërkuar me lartë, përfshirë shtojcat, subjektet aplikuese do të diskualifikohen dhe nuk do të shqyrtohen për vlerësim.

## **4. Subjektet afariste që nuk kualifikohen**

Subjektet afariste të cilat kanë bankrotuar apo janë në mbyllje, janë nën administrim të gjykatave, kanë pezulluar aktivitetet afariste, apo i janë nënshtruar procedurave në lidhje me këto çështje, nuk mund të jenë përfitues të skemës përkatëse.

## **5. Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e planifikuar e projektit që financohet nga MINT/KIESA nuk mund të tejkalojë një (1) vit që nga nënshkrimi i kontratës ndërmjet dy palëve (përveç nëse ndryshe parashihet me kushtet e kontratës apo raportit të komisionit monitorues).

## **6. Sqarime shtesë**

- Dokumentacioni mund të dorëzohet në gjuhën shqipe, angleze ose serbe.
- Ndërmarrjet që kanë përfituar subvencionim me mjete financiare për certifikim të produktit gjatë vitit 2023 në kuadër të KIESA-së, nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga kjo thirrje. Brenda vitit 2024 kompania e njëjtë nuk mund të jete përfituese paralel në dy grant skemat, atë të certifikimit dhe makinerisë.
- Në rast që ndërmarrja do të jetë përfitues, atëherë do të nënshkruhet marrëveshje dypalëshe (MINT/KIESA dhe ndërmarrje), pjesë e secilës do të jenë edhe deklaratimet që janë bërë me rastin e aplikimit.
- Fushë veprimtaria e ndërmarrjeve, e ndryshuar pas shpalljes së thirrjes me qëllim të vetëm për të përfituar nga kjo skemë, nuk do të merret parasysh.
- Pas nënshkrimit të marrëveshjes, ndërmarrjes përfituese do t'i transferohen 80% e vlerës së aprovuar, ndërsa 20% e vlerës së mbetur do t'i transferohen pas

realizimit të projektit. Para nënshkrimit të marrëveshjes, ndërmarrjet përfituese obligohen të sjellin garancion nga kompanitë e sigurimit apo nga bankat, për vlerën totale të grantit.

- TVSH është shpenzim i pranueshëm vetëm për persona fizik dhe ndërmarrje jo deklaruese të TVSH-së. Për ndërmarrjet që janë deklaruese të TVSH-së, ky është shpenzim i papranueshëm.
- Ndryshimi i ofertës mund të bëhet vetëm me kërkesë të veçantë e cila parashtrohet në MINT/KIESA, respektivisht në komisionin monitorues. Kërkesa duhet të mbështetet në arsye të qëndrueshme nga përfituesi dhe e njëjta mund të implementohet vetëm pas miratimit të kërkesës dhe nuk ndryshohet koncepti i projektit dhe shuma e grantit nga Ministria. Në rastet kur kemi ofertues me çmime më të larta se ato të prezantuara në projektin aplikues, atëherë ndryshimet e çmimeve janë obligim i përfituesit dhe në asnjë rast nuk ndryshon vlera e grantit nga Ministria.
- Përfitues do të jenë ndërmarrjet që janë renditur më pikë më të larta nga komisioni vlerësues, varësisht prej limiteve buxhetore të planifikuara.
- Në ueb të MINT/KIESA do të publikohet lista e ndërmarrjeve përfituese.

## 7. Si te aplikohet?

Njoftimi për thirrje publike është i publikuar në ueb faqen e MINT dhe të KIESA-së i në vijmë:

- <https://mint.rks-gov.net/>
- <http://kiesa.rks-gov.net/>

Aplikimi bëhet përmes portalit e-Kosova. Afati për dorëzimin e aplikacionit dhe dokumenteve përcjellëse është deri më datë 19.04.2024 . Ndërsa, informatat shtesë mund të merren përmes email adresës: [sme.kiesa@rks-gov.net](mailto:sme.kiesa@rks-gov.net) konform U.A.01/2018, jo më vonë se pesë (5) ditë para mbylljes së thirrjes publike.

## 8. Kriteret e vlerësimit

| # | Vlerësimi:                                                                                                                   | Pikët maksimale |                  |                  |
|---|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|------------------|------------------|
|   |                                                                                                                              | Lot 1<br>mikro  | Lot 2 e<br>vogël | Lot 3 e<br>mesme |
| 1 | Projekt propozimi <sup>3</sup>                                                                                               | 25              | 25               | 25               |
| 2 | Ndërmarrja e certifikuar me ISO 9001 <sup>4</sup>                                                                            | 20              | 20               | 20               |
| 3 | Qarkullimi i deklaruar dhe i dëshmuar nga ATK për vitin 2023 <sup>5</sup>                                                    | 20              | 20               | 20               |
| 4 | Eksporti i dëshmuar nga Dogana e Kosovës për vitin 2023 <sup>6</sup>                                                         | 20              | 20               | 20               |
| 5 | Aplikuesi të dëshmoj se zbaton standardin/et përkatës që mbulon produktin apo sistemin përkatës të certifikimit <sup>7</sup> | 15              | 15               | 15               |

## 9. Ankesat

Pas publikimit të rezultateve preliminare aplikuesit mund të adresojnë ankesa brenda afatit të paraparë me UA 01/2018, në platformën e-Kosova.

### Shënim:

Në rast se informatat e dhëna në këtë aplikacion vërtetohen që janë të pa sakta, subjektit nuk do t'i realizohet pagesa dhe i njëjti do të mbaj përgjegjësi për të gjitha pasojat, sipas legjislacioneve relevante në fuqi.

<sup>3</sup> Të paraqiten në projekt propozim, qëllimi, aktivitet e projektit, kosto financiare, plani kohor e projektit, strukturën organizative të aplikuesit, kapacitetet aktuale prodhuese dhe synimet e rritjes së prodhimit dhe eksportit në rast të përfitimit të përkrahjes financiare. Po ashtu, rëndësia e propozimit me prioritetet e thirrjes, sa janë aktivitetet e realizueshme dhe të qëndrueshme në lidhje me rezultatet e pritshme dhe rreziqet e mundshme, si dhe mënyra e implementimit të projektit sa i përket certifikimit të produktit.

<sup>4</sup> Certifikata ISO 9001 duhet të jetë valide dhe e njohur ndërkombëtarisht. Trupi certifikues i cili ka lëshuar certifikatën duhet të jetë i akredituar nga një trup akreditues i njohur ndërkombëtarisht.

<sup>5</sup> Qarkullimi vjetor për vitin 2023 të dëshmohet me dokument të lëshuar nga ATK. Kjo nënkupton totalin e qarkullimi të biznesit për vitin 2023.

<sup>6</sup> Eksporti për vitin 2023 të dëshmohet me dokument të lëshuar nga Dogana e Kosovës. Kjo nënkupton totalin e eksportit të biznesit për vitin 2023.

<sup>7</sup> Kjo dëshmohet përmes faturës blerëse të standardit ose përmes deklaratës nën betim që zbaton standardin apo sistemin përkatës të certifikimit.